



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**

**Komuna e Prishtinës**  
**Opština Priština -Municipality of Prishtina**



Në bazë të dispozitave të nenit 12, paragrafi 12.2, pika d e Ligjit nr. 03/ L - 040, për vetëqeverisje lokale ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës", nr. 28/15 qershor 2008), të dispozitave të nenit 30 të Ligjit nr. 03/L-175, për borxhet publike dhe të dispozitave të nenit 34, paragrafi 34.1, pika d e Statutit të Komunës së Prishtinës, 01. nr. 110 - 391, të dt. 25.2.2010, Kuvendi i Komunës së Prishtinës, në mbledhjen e mbajtur më 23.03.2021, merr këtë

**V E N D I M**

**Neni 1**

- I. **AUTORIZOHET** marrja e borxhit nga Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZH) në formën e borxhit afatgjatë për financimin e masave të efijencës së energjisë në 47 ndërtesa komunale.

**Neni 2**

- II. Borxhi i cekur në pikën 1 të këtij vendimi, do të jetë nën kushtet si në vijim:

- a) Borxhi deri në vlerën prej 5,000,000.00 € ;
- b) Norma e interesit në 3.5 % në vit (diferenca e normës së interesit), si dhe normës gjashtëmujore EURIBOR, me nivelin më të ulët prej 0% EURIBOR (baza e normës së interesit);
- c) Forma e borxhit është marrëveshje e kredisë;
- d) Kthimi i kredisë duhet të bëhet në 14 këste të barabarta gjashtëmujore, duke filluar nga dt. 15.01.2024 dhe përfundon më 15.07.2030 ;
- e) Tarifa e zotimit është 0.5 % në vitin për shumën e padisbursuar të kredisë, që fillon 60 ditë pas ekzekutimit të marrëveshjes së kredisë;
- f) Norma e përqindjes së tarifës në fillim të transaksionit (Front End) është 1 % e shumës së kryegjësë së kredisë, e pagueshme pesë ditë pune para disbursimit të parë ose 30 ditë pas ekzekutimit të marrëveshjes së kredisë, cilado që vije e para;

- g) Parapagimi vullnetar - Komuna mund të parapaguajë të gjithë ose një pjesë të kredisë në çdo datë të pagesës së interesit, në varësi se sa vijon (i) tarifa e parapagimit: 0.125% e shumës së parapaguar ; dhe (ii) shuma minimale e parapagimit është 1 milion € ;
- h) Qëllimi i huamarrjes është financimi i masave të eficientës së energjisë në ndërtesat në pronësi komunale;
- i) Burimi i sigurisë për shlyerjen e kredisë do të jetë :
1. Garancia e arkëtueshme që konsiston në instrumentin, sipas të cilit Komuna i jep BERZH-it një interes të rangut të parë të sigurisë mbi : (a) deri në 25 % të të hyrave vetanake të Komunës dhe (b) deri në 25 % të granteve të përgjithshme që Komuna i merr nga Qeveria e Republikës së Kosovës në kuadër të buxhetit të konsoliduar;
  2. Garancia e llogarisë së rezervës së shërbimit të borxhit që përbëhet nga instrumenti, në përputhje me të cilin Komuna i jep BERZH-it një interes të rangut të parë të sigurisë në një llogari rezervë të shërbimit të borxhit në emër të Komunës, e hapur në një bankë tregtare të pranueshme për BERZH-in, e shprehur në EURO me bilancin e gjendjes së parasë së gatshme, i cili gjatë gjithë kohës është jo më i ulët se kundërvlera e servisimit total të borxhit gjysmë - vjetor (përfshirë kryegjënë, interesin dhe tarifat) për t'iu paguar BERZH-it sipas marrëveshjes së kredisë midis BERZH-it dhe Komunës (marrëveshja e kredisë) në datën përkatëse të pagesës së interesit;
  3. Marrëveshja e interceptimit që konsiston në një marrëveshje ndërmjet Komunës dhe BERZH-it, në bazë të së cilës në rast të mospagimit, të gjitha pagesat nga Komuna nën dokumentet e financimit, do të bëhen direkt nga Ministria e Financave e Republikës së Kosovës për BERZH-in, nga transferimet e pakushtezuara që i paguhen Komunës nga Ministria e Financave;
- j) Marrëveshja e kredisë do të rregullohet sipas ligjit anglez dhe mosmarrëveshjet do të zgjidhen përmes arbitrazhit në Londër, sipas rregullave të UNCITRAL, ose sipas opsionit të Bankës, juridiksioni jo-ekskluziv i gjykatave angleze, dhe Komuna duhet që gjatë gjithë kohës të ketë një agjent për shërbimin e procesit në Angli.

### Neni 3

- III. Pjesë përbërëse e këtij vendimi është edhe marrëveshja e parafinancimit, e lidhur me Bankën Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim, e dt. 19.09.2019, dhe dokumentet mbi termat dhe kushtet e kredisë/borxhit.

#### Neni 4

- IV. Ky borxh i nënshtrohet miratimit paraprak nga Ministria e Financave.

#### Neni 5

- V. Marrja e borxhit e cekur si në pikën I të këtij vendimi dhe nën kushtet e cekura si në pikën 2 të këtij vendimi, është në përputhje me kufizimet e vendosura në nenin 32 të Ligjit për borxhin publik, nr. 03/L-175.

#### Neni 6

- VI. Pjesë përbërëse e këtij vendimi është edhe Projeksi i të ardhurave totale të buxhetuara dhe shpenzimeve totale buxhetore për çdo vit, duke përfshirë vitin në të cilin kredia është planifikuar të paguhet e plotë, duke përfshirë supozimet materiale në të cilat bazohen parashikimet.

#### Neni 7

- VII. Për zbatimin e këtij vendimi, do të kujdeset Kryetari i Komunës dhe drejtoritë e tjera relevante me të.

#### Neni 8

- VIII. Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal, si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në ueb-faqen e Komunës.

KUVENDI I KOMUNËS SË PRISHTINËS  
01-030/01-54352/21, më 23.03.2021

KRYESUESI I KUVENDIT  
Agim Kuleta

